



“FUQIZIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI”

Trajnim: Cikli i Menaxhimit të Projektit CPM

25 gusht 2021

Projekt quhet një përpjekje e përkohëshme, ndërmarrë për të krijuar një produkt apo shërbim i cili është unik.

I **përkohshëm** pasi çdo projekt në dallim nga programet apo politikat ka një cikël veprimtarie më afatshkurtër. **Unik** pasi produkti apo shërbimi krijohen si rrjedhojë e qasjes që grupi i punës koncepton në projekt-propozim.

Sipas KE, projekt quhet një seri aktivitete të cilat synojnë qartësisht arritjen e objektivave dhe përmbushjen e indikatorëve të parashikuar. Këto brenda afatit të parashikuar si edhe brenda një buxheti të përcaktuar:

Kusht 1: Indikatore të matshme

Kusht 2: Marrëveshje bashkëpunimi paraprake

Kusht 3: Monitorim, Vlerësim, Raportim

Kusht 4: Qëndrueshmëri në kohë

Kusht 5: Inovacion

Në të gjithë përkufizimet vihet re se ka disa elemente të rëndësishme që karakterizojnë një projekt, që janë pikërisht:

Kosto (buxheti/ burimet),

Koha (efektiviteti ndërhyrjes dhe lidhja me kontekstin)

Qëllimi (detyrat dhe indikatorët që do të influencohen).

Duke e thjeshtuar diskutimin mund të themi se:

me përcaktimin e tri elementeve, i katërti përcaktohet si funksion i tre të parave.

(PROJEKTI)

Dallimet Projekt vs Pune



	Projekti	Punë të tjera
Lloji i punës	Unik. Ndodh një herë. Shpesh përfshin ndryshim.	E përsëritshme dhe e vazhdueshme.
Fokusi	Zbatimi/mbyllja me sukses i projektit	Operacione, kryerja me efektivitet e punës
Përgjegjësia manaxhimit	Manaxhimi i punës	Manaxhim i njerëzve
Buxheti	Financim i aktiviteteve dhe nderhyrjeve specifike	Buxhete të vazhdueshme, operacionale
Aftësia për t'u përshtatur	Përshtatshmëri e lartë në kohe të shkurtër	Përshtatshmëri e ulët në kohë të gjatë
Standarte dhe konsistencë	Standarte të kufizuara – unike për nga natyra	Standarte të industrisë
Risku	Nivel i lartë – punë unike dhe e panjohur	Qëndrueshmëri e lartë – punë e vazhdueshme
Vizibiliteti	I lartë – për shkak të arritjes ose jo të objektivave	Vizibilitet i ulët nëse standartet nuk janë arrirë


I. Menaxhimi i projektit është zbatimi në aktivitetet e projektit i njohurive, aftësive, instrumenteve, dhe teknikave për të arritur dhe tejkaluar nevojat dhe pritshmërinë e paleve të interesuarve për projektin.

Të arrish apo tejkalosh këto objektivin do të thotë të përpiqesh të baraspeshosh në vazhdimësi kërkesa konkurruese midis:

- shtrirjes (detyrës), kostos, kohës dhe performancës;
- të interesuarve me nevoja dhe pritmëri të ndryshme;
- kërkesave të identifikuara (nevojat) dhe atyre të paidentifikuara (pritshmëritë);

II. Menaxhimi i projektit është të optimizojë koston, kohën dhe cilësinë e projektit. Një nga mënyrat për t'u arrirë, është nëpërmjet kontrollit të ushtruar nga manaxhuesi i projektit mbi burimet, brenda kohës, kostove dhe performancës së kërkuar. Numri më i madh i kompanive kanë 6 lloj burimesh:

- Burime financiare, njerëzore, asete
- Shërbime
- Materiale, Teknologji / Informacion



- ❑ Kjo fazë shërben për të konceptuar një projekt.

Si pikënisje shërben misioni i organizatës/institucionit, strategjia e zgjedhur, konteksti i jashtëm së bashku me kufizimet që ai vendos.

Disa nga aktivitete kryesore të kësaj faze janë:

- ❖ *Kerkimi, hulumtimi, krijimi databazes me informacion dhe vendosja e kontekstit historik dhe atij aktual*
- ❖ *Organizimi i takimeve midis NJQV, komunitetit apo edhe grupimeve jo-formale për mundësinë e bashkëpunimit;*
- ❖ *Identifikimi i mangesive ne burime, asete, permbushje te detyriemve ligjore, kapacitete apo veprime operacionale;*
- ❖ *Krijimi i grupit të punës me pergjegjesi specifike ne organigramen e propozuar;*
- ❖ *Identifikimi I indikatoreve sipas gjendjes ekzistuese lidhur me problemin që synon të zgjidhe ose shërbimin që synon të ofrojë projekti i bashkëpunimit;*
- ❖ *Identifikimi i kornizes ligjore mundesuese apo penguese ne raport me nderhyrjen;*
- ❖ *Hartimi i një marrëveshje paraprake bashkëpunimi ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.*

- ❑ Planifikimi i projektit është procesi i **zbërthimit të projekt-idesë** deri sa të arrihet në caktimin e aktiviteteve konkrete të shoqëruara me informacionin përkatës lidhur me kohën e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, lidhjen e tij logjike me aktivitete të tjera, si dhe burimet financiare, njerëzore e teknologjike të nevojshme për kryerjen e tij.
- ❑ **Elemente të rëndësishme të lidhura me procesin e planifikimit:**
 - **inputet**, që mund të jenë plane të mëparshme (d.m.th. outpute të proceseve të mëparshme të planifikimit), informacione historike të organizatës, politikat e organizatës, kufizimet (financiare, ligjore, institucionale, etj.), dhe risqet;
 - **instrumentet dhe teknikat** që përfshijnë metodologjinë e planifikimit (qasje e strukturuar që udhëheq ekipin planifikues drejt rezultatit), aftësitë dhe njohuritë e planifikuesve;
 - **outputet** ku përfshihet plani – si një dokument i miratuar që shërben si bazë për menaxhimin dhe kontrollin e projektit – si dhe detaje të tjera mbështetëse (informacione shtesë të gjeneruara gjatë procesit të planifikimit, detaje teknike, përmbledhje standardesh dhe referencash, etj.)

- ❑ Zbatimi i projektit është faza më e rëndësishme e ciklit të projektit, që konsiston në tërësinë e masave që duhen marrë për të zbatuar planin, reaguar ndaj ndryshimeve të mjedisit, dhe në fund të fundit për të nxjerrë produktin e kërkuar apo arritur qëllimin e vënë duke respektuar elementet kryesore të projektit.
- ❑ **Elemente të rëndësishme të lidhura me procesin e zbatimit:**
 - **inputet:** ku përfshihen plani i projektit, detajet mbështetëse, politikat e kompanisë / organizatës, dhe masat korrektuese (që në fakt janë output i procesit të kontrollit dhe monitorimit, por këtu të përfshira tek inputet duke nënkuptuar “feed-backun” që i jepet menaxhereve të projektit);
 - **instrumentat dhe teknikat:** aftësitë e përgjithshme menaxherie, **njohuritë**, sistemi formal i procedurave, që sanksionon projektin, **takimet periodike** informuese në nivele të ndryshme, si dhe sistemi i informacionit të menaxhimit të projektit, i cili mbledh, përpunon dhe shpërndan informacionin nga të gjitha proceset e tjera të menaxhimit të projektit;
 - **outputet:** janë rezultatet konkrete të punës dhe eventualisht kërkesa për ndryshime që kanë rezultuar në zbatim e sipër.

- ☐ **Vlerësimi** i projektit është një proces sistematik me anë të të cilit matet shkalla e efektivitetit dhe efijencës së arritjeve të projektit.
- ☐ Rezultatet e vlerësimit të projektit vlejné jo vetëm për të kuptuar të shkuarën, por edhe për të planifikuar më mirë të ardhmen.

Një vlerësim duhet të garantojë që informacioni është i besueshëm dhe i dobishëm, të mundësojë përfshirjen e konkluzoiveve dhe mësimëve të nxjerra në procesin e vendimmarrjes si të zbatuesit/përfituesit ashtu edhe të donatorit.

- ☐ Vlerësimi i projektit, që bëhet zakonisht në mbyllje të tij, nuk duhet të ngatërrohet me **monitorimin**, që është një proces bashkëshoqërues i fazës së zbatimit.
- ☐ **Monitorimi** - shoqëron në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe zbatimin e projektit
 - mekanizëm “vetëkontrolli”;
 - hedh dritë mbi progresin e projektit;
 - kryhet nga personat përgjegjës për realizimin e aktiviteteve (kryesisht stafi i projektit dhe partnerët e tjerë zbatues).

KORNIZA LOGJIKE



Përmbledhje	Treguesit	Burimet	Supozimet
Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të pastrimit në VORE	Shërbimi i pastrimit kryhet në bashki, mbulimi me teper territor	Vizita në vend; Raporte	
Objektivat: - Hartimi i planit vendore; - Ndërtim i infrastrukturës së shërbimit; - Ndërgjegjësim i komunitetit; - Rritja e kapaciteteve të stafit.	Infrastruktura e ngritur (1 makinë teknologjike, 54 kontejnerë, 21 pika grumbullimi, 17 bazamente betoni); 3 takime me grupet e interesit; Stafi i aftë për ofrimin/monitorim	Skema ndërvendore, kostot, rekomandimet për tarifat e pastrimit; Grafiku i shërbimit	Respektimi i marrëveshjes së hartuar nga bashkitë
Rezultatet - Krijimi dhe përdorimi i një skeme efektive dhe efçente; - Infrastrukturë e përmirësuar; - Vend-depozitimi i mbetjeve sipas kërkesave; - Komunitet i ndërgjegjësuar dhe i përfshirë; - Staf i trajnuar për ofrimin e shërbimit.	Performanca e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve e vlerësuar në mënyrë periodike; Performancë e rritur e stafit të shërbimit; % e banorëve shprehen të kënaqur me shërbimin.	Formularët e plotësuar të matjes së perfomances dhe raporti i vlerësimit; Lejet mjedisore për venddepozitimin; akt kolaudimi i punimeve, urdhër pagesat.	Marrëveshje për ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit të pastrimit
Aktivitetet - Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit; - Hartimi i skemës efektive për MIM ndërvendore; - Prokurimi i pajisjeve dhe punimeve; - Rehabilitimi i infrastrukturës së mbetjeve; - Trajnimi i stafit teknik; fushata të sensibilizimit dhe edukimit.	80,000 Euro - Vlera e projektit 68,000 Euro - Buxheti i kërkuar nga donatorët 12,000 Euro - Buxheti i kontribuar nga bashkia		Vend depozitimi i mbetjeve urbane nuk ka probleme pronësie; Stafi i bashkisë i gatshëm të marrë pjesë në trajnime; Komuniteti i hapur ndaj informimit
Përputhje me strategjinë kombëtare			

- ☐ Grantet e Inisiatives do te mbeshtesin NGO te reja, lokale me grante 1'500 - 10'000 Euro.
- ☐ Grantet e Partenritetit do te mbeshtesin NGO te konsoliduara me veprim rajonal me grante 10'000 - 40'000 Euro.
- ☐ 25% e buxhetit mund dhe keshillohet te planifikohet per INVESTIME konkrete ne funksion te nderhyrjes.
- ☐ Cdo blerje apo investim direkt me vlere mbi 2'500 Euro duhet ti nenshtrohet procedures se publikimit dhe vleresimit te minimalisht 3 ofertave duke aplikuar cmimet reference te tregut ne Shqiperi.
- ☐ Pagat, shpenzimet administrative si edhe ato operacionale duhet te jene ne linje me cmimet qe aktualisht aplikohen ne tregun vendas.
- ☐ Vizibiliteti, komunikimi dhe mediatizimi ceshtjes tuaj duhet te parashikohet ne shpenzimet dhe ne buxhet.

Keshille: Buxhetoni aktivitetet e listuara ne piken 5.1 te dokumentit ANEKS 1: Forma Aplikimit

- ☐ Ne te gjitha grantet keshillohet qe lidhja ndermejt ceshtjes mjedisore dhe gender te kete nje fokus te dedikuar.
- ☐ Indikatore dhe monitorim I detajuar duhet te parashikohen ne raport me mardhenien mjedis-gender te ceshtjes qe parashikoni te adresoni.
- ☐ Nje udhezues i dedikuar mbi aspektet gjinore do te vihet ne dispozicion nga konsorciumi per te gjithë projektet fituese.

- ☐ Green-AL ka nje strategji komunikimi te miratuar si edhe udhezuesin perkates mbi te cilin te gjithe projektet fituese duhet te mbeshtesin menyren dhe procesin e komunikimit.
- ☐ Keshillojme qe vizibiliteti, mediatizimi dhe ndarja per publikun e produkteve te projekteve tuaja te jete pjese perberese e propozimit duke parashikuar edhe buxhet te dedikuar per ate.

FORMA APLIKIMIT

1. PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE



- ☐ ANGLISHT DHE SHQIP (150 -200 fjale secila)
- ☐ Sintetizoni propozimin pa perseritur objektivin, qellimin apo indikatorët por vetem duke adresuar problematiken dhe rezultatin qe prisni nga nderhyrja juaj
- ☐ Kujdes me gramatiken dhe fjalite e zgjatura.

2. INFORMACIONI APLIKANTIT



- ☐ ANGLISHT DHE SHQIP
- ☐ Te gjitha referencat duhet te jene te sakta dhe te aksesueshme. (web, nr telefoni, email etj)
- ☐ Kujdes me gramatiken dhe referencat e dokumenteve zyrtare.

3. PERSHKRIMI PROJEKTIT



- ☐ Te plotesohet ne Shqip
- ☐ Tabela jo me teper se 2 faqe
- ☐ Titulli (keshillohet jo l gjate, preferohen akronime apo shkurtime te titullit te gjate)
- ☐ Vendndodhja: Te jete sa me specifike per aplikantet e iniciatives
- ☐ Kohezgjatja ne muaj e projektit (nenshkrimi kontratave dhe fillimi punes parashikohet ne mes te Nentorit)
- ☐ Shuma / Buxheti (te shprehet ne Euro dhe te jete brenda intervalit te percaktuar Min/Max nga tipologjia grantit)
- ☐ Specifikoni me emra grupet e interest, targetuar dhe perfituesit
- ☐ Rezultatet dhe Aktivitetet (te shprehen qarte, shkurt dhe te jene gjithnje ne funksion te arritjes se indikatorëve qe keni parashtruar)

4. PERSHKRIMI NARRATIV



- ☐ Te plotesohet ne Shqip
- ☐ Iniciativa maksimumi 5fq , Partneriteti maksimumi 7fq
- ☐ Sfondi dhe rendesia e nderhyrjes se propozuar
- ☐ Indikatoret
- ☐ Ekspertiza teknike dhe tematike
- ☐ Qasja inovatore ne projektin tuaj

4. PERSHKRIMI NARRATIV



- ☐ 4.1: Justifikimi Projektit (gjendja ekzistuese duhet te jete me te dhena sasiore, cilesore dhe fakte)
- ☐ 4.2: Specifikoni mardhenien me grupet e interest
- ☐ 4.3: Objektivat e projektit te jene ne linje me prioritetin 1 te programit (dok. Udhezuesit fq.6)
- ☐ 4.4: Aktivitetet te jene sa me te qarta, praktike dhe brenda parashikimeve (nuk favorizohen aktivitete teorike)
- ☐ 4.5: Metodologjia e zbatimit duhet te reflektoje rrugen qe do te ndiqni per zbatimin e konceptit tuaj. Arsyen pse keni zgjedhur nje metodologji te tille ku argumentoni efektivitetin e saj. Pranohen qasje alternative ne perpilimin e metodologjise. Cdo metodologji nese nderton mbi nje ekzistuese duhet te referohet, mungesa e referencave do te konsiderohet plagjiature dhe si e tille do te penalizojne te gjithë propozimin.
- ☐ 4.6: Impakti I projektit duhet te ndahet ne dy paragrafe (pjesa teorike dhe pjesa sasiore)

KONSIDERATA:



- ☐ 5. Plani punes duhet te ndertohem mbi formatin e gatshem. Aktivitetet duhen grupuar sipas rezultateve qe priten prej tyre
- ☐ 5.1 Aktivitetet ne nivel program, keshillohet te perfshihen si pjese e paketes tuaj. Pra te jene ne sinkron me propozimin dhe jo te dalin te diferencuara
- ☐ 6. Buxheti
- ☐ 7. Korniza logjike duhet te ndertohet ne forme tabelare ku te permbaje ne kolona Permbledhjen (ku ne rrjeshta te vendosen qellimi, objektivat, rezultatet dhe aktivitetet) Treguesit, Burimet, Supozimet, Risqet dhe adresimin e tyre
- ☐ 8. Pervoja aplikantit ne 5 vitet e fundit. Sygjerojme te perfshini vetem experience te ngjashme me konceptin qe po ndertoni nese keni. Po ashtu eshte me rendesi qe ne pershkrim te perfshihen referenca, linqe te produkteve qe keni prodhuar.
- ☐ 9-10 Per deklaraten e aplikantit si edhe per mandatin duhet te rrespektoni formatin dhe firmat e vulat te jene origjinale ne kopjen fizike
- ☐ Memorandumin e bashkepunimit mund ta konceptoni dhe formatoni vete.

INOVACIONI dhe QENDRUESHMERIA: (shembuj)

- Eleminimi plastikes me 1 perdorim ne te gjithë aktivitetet tuaja
- Printime gjithnje ne material te ricikluar
- Produkt qe i reziston kohes
- Monitorim Mjedisor
- Ndergjegjesimi Mjedisor (rezulton si aktiviteti me i kerkuar nga NA por ne asnje rast nuk do mbeshtetet nese ka vetem diskurs teorik)

Nese i referoheni udhezuesit, seksionit VLERESIMI DHE PERZGJEDHJA APLIKANTEVE elementet e mesiperm kane 30/100 pike ne total

HULUMTIMI DHE PUBLIKIMI SHKENCOR:

Perpos adresimit te ceshtjeve lokale ju ftojme te trajtoni ceshtjet:

- Evidentim i ndryshimeve apo nderhyrjeve madhore te **Regjimit Hidrik** ne rajonin/bashkine tuaj
- Evidentimi I problemeve ne raport me **thatesiren**
- Evidentimi I problemeve ne raport me **temperaturat e larta**
- Evidentimi I problemeve ne raport me **perbytjet**
- Evidentimi I problemve ne raport me humbjen e **habitatit, biodiversitetit dhe sherbimeve te ekosistemit**
- Evidentimi problemeve ne raport me **erozionin tokesor dhe detar**
- Evidentimi I problemeve ne raport me **renien e prezences se debores dhe eres**
- Evidentimi I problemeve ne raport me **ndotjen urbane, industriale**

Per reference Sinteza IPPC per Mesdheun dhe Ballkanin Perendimor: https://www.ipcc.ch/report/ar6/wg1/downloads/factsheets/IPCC_AR6_WGI_Regional_Fact_Sheet_Europe.pdf

Keshille: Hulumtimi dhe shkrimi artikujve shkencore do te ishte ideale te udhehiqet nga nje department I fakulteteve ne Shqiperi, ku ju mbeshtesni financiarisht pershtatjen e nje praktike mesimore, detyre kursi, vizite hulumtuese ne terren.

SQARIME ...

- **Qëllimi:** Rritja e sigurisë dhe aksesueshmërisë së ambjenteve publike

(Qëllimi është arsyeja përse fillon të hartohet një projekt, problematika madhore për të cilën kërkohet zgjidhje.)

- **Objektivi i përgjithshëm:** Ndriçimi sheshit kryesor të fshatit XXX deri në vitin 2022.

(Një objektivi i nivelit të lartë në të cilën ndërhyrja do të kontribuojë. Ndërhyrjet e tjera dhe aktivitetet do të kontribuojnë në realizimin e këtij objektivi)

- **Objektivat specifik:** _____

- **Aktivitetet:** _____

(Aktivitetet që duhet të zhvillohen nga grupi i punës së projektit në mënyrë që të arrihen rezultatet. Sërë aktivitetesh që është e nevojshme për të prodhuar rezultatin e përcaktuar.)

- **Indikatore:** _____

(Janë njësitë matëse, si ju masni suksesin e projektit dhe arritjen e objektivave)

- **Grupet e interesit:** _____

(Janë të gjithë ata persona apo institucione të cilët janë prekur në mënyrë direkte apo indirekte nga projekti.)

- **Buxheti:** _____

(Sa para do të shpenzohen për realizimin e këtij projekti.)

- **Kohëzgjatja:** _____

(Sa kohë do tju duhet të zhvilloni projektin duke e specifikuar për aktivitet.)

Erni Kocani

E-mail: erni_kocani@co-plan.org

Nr. Kontakti: 0692724774

Paola Zhamo

E-mail: paola_zhamo@co-plan.org